



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1347 , datë 23.07.2010**

**Për**

**“Shqyrtimin e ankimit administrativ te Vodafone Albania sh.a. per ndryshimin, te Aktit Administrativ, Vendim nr.1211, date 31.03.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Vodafone Albania sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 23.07. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Shqyrtim i Ankimit administrativ te Vodafone Albania sh.a. per ndryshimin e Aktit Administrativ, Vendim nr.1211, date 31.03.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Vodafone Albania sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”

**BAZA LIGJORE:**

1. Germa ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);

2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**K.Pr.A**)
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918
4. “Rregullore për analizen e tregut”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 747, date 17.07.2009 (**Rregullorja**).
5. Rregullore për Aksesin dhe Interkoneksionin miratuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010
6. Vendim i KD nr. 1211, datë 31.03.2010 “Percaktimin e sipërmarresit Vodafone Albania sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Ankim administrativ i sipërmarresit Vodafone Albania s.h.a, paraqitur me shkresë nr.1422/1, date 07.05.2010 me objekt “Ndryshimin e Vendimit nr.1211, date 31.03.2010 të AKEP, “Për percaktimin e sipërmarresit Vodafone Albania sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese” (**Ankim Administrativ**);
  - Vendim nr.1211 date 31.03.2010 “Për percaktimin e sipërmarresit Vodafone Albania sh.a Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;
  - Projektvendim i KD të AKEP “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone Albania sh.a, për ndryshimin e Aktit Administrativ, Vendim nr.1211, date 31.03.2010 të AKEP, “Për percaktimin e sipërmarresit Vodafone Albania sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese” (**Projektvendimi**);
  - Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**);
- si dhe,  
diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N:**

1. Sipërmarresi Vodafone Albania sh.a me shkresën nr.1422/1 prot, date 07.05.2010 brenda afatit ligjor të percaktuar në nenin 140 të ligjit nr.8485, ka bërë ankim administrativ me objekt “Për ndryshimin e Aktit Administrativ, Vendim nr.1211, date 31.03.2010 të AKEP, “Për percaktimin e sipërmarresit Vodafone Albania sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;
2. Ankimi administrativ i Vodafone Albania sh.a për ndryshimin e Aktit Administrativ, Vendim nr.1211, date 31.03.2010 të AKEP, “Për percaktimin e sipërmarresit

Vodafone Albania sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, kerkon:

1. mosperfshirjen e thirrjeve nderkombetare ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik te levizshem te Vodafone Albania;
  2. heqjen e asimetrise midis tarifave te terminimit te Vodafone Albania dhe te operatoreve te tjere te telefonise se levizshme;
  3. heqjen e rregullimit ex-ante per tregun me shumice te akses origjinimit, mospercaktimin e Vodafone Albania organizem me fuqi te ndjeshme ne kete treg si dhe heqja e detyrimeve perkatese rregullatore (pikat 1, 1.2, 5 dhe 6 te Vendimit nr. 1211)
3. Ankimi administrativ i Vodafone Albania sh.a. per ndryshimin e Aktit Administrativ, Vendim nr.1211, date 31.03.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Vodafone Albania sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, pezullon efektet e tij, nga data e depozitimit te ankimit ne AKEP deri ne marrjen e nje vendimi perfundimtar te AKEP mbi ankimin administrativ.
4. AKEP, bazuar ne:
- a. shqyrtimin e arsyesimit te perdorur ne analizen e tregut celular, pjese e VKD nr. 1211, date 31.03.2010, per shkak te ankimit administrativ te sipermarresit Vodafone Albania sh.a si dhe ankimeve administrative te AMC dhe Eagle Mobile;
  - b. percaktimet ne ligjin nr. 9918, neni 42, pika 1, e tij,

*“AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin për të plotësuar kërkesat e arsyeshme për akses dhe interkoneksion, si dhe për përdorimin e elementeve të veçanta të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, në veçanti, në ato raste kur AKEP-i vlerëson se nga refuzimi i aksesit ose nga kushtet dhe termat e paarsyeshme, **pengohet konkurrenca e qëndrueshme në tregun e pakicës, apo kur dëmtohen interesat e përdoruesve fundorë**”.*

- c. Ne perkufizimin e tregjeve perkatese, BE ne rekomandimet e saj (rekomandimi i BE, 11.02.2003 per tregjet perkates, pika 7 dhe rekomandimi i vitit 2007)<sup>1</sup>, thekson se pikenisja per perkufizimin e tregjeve me shumice eshte perkufizimi i tregjeve me pakice te cilet jane tregjet e lidhur me oferen dhe kerkesen e perdoruesve fundore. Pas ketij percaktimi te tregjeve me pakice behet percaktimi i tregjeve me shumice qe perfshijne oferten dhe kerkesen per sherbime te ofruara operatoreve me qellim ofrimin e sherbimeve perdoruesve fundore.

---

<sup>1</sup> The starting point for the definition and identification of markets is a characterisation of retail markets over a given time horizon, taking into account demand-side and supply-side substitutability. Having characterised and defined retail markets which are markets involving the supply and demand of end users, it is then appropriate to identify relevant wholesale markets which are markets involving the demand of products of, and supply of products to, a third party wishing to supply end users.

- d. sherbimi i tranzitimit të thirrjeve hyrese nderkombetare, pavaresisht teknologjise, sipas parimit të njohur “Pala Thirrese Pagan” (Calling Party Pays-CPP) është një shërbim që shërben si input për operatorët tranzitues për ta rishitur këto shërbime duke e ofruar për operatorët e huaja për të realizuar thirrje të përdoruesve fundorë në këto shtete të huaja, pra me impakt në tregjet me pakicë në shtetet e huaja.
  - e. vendimet dhe qendrimi i AKEP për terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare dhe imponimi i ofrimit të terminimit në rrjetet e operatorëve me FNT për operatorët tranzitues për thirrjet hyrese nderkombetare, ka çuar në rritje të stimujve të ofrimit të kësaj shërbimi, por njëkohësisht edhe me probleme për CLI dhe cilësinë e trafikut hyres nderkombetar, duke ndikuar indirekt edhe në trafikun kombëtar dhe thirrjet e abonenteve në Shqipëri. Njëkohësisht këto stimuj të lartë për ofrim shërbimi tranzitim hyres nderkombetar duket se kanë reduktuar stimujt për investime në infrastrukture fizike backbone, pasi shpesh përdoren vetëm aksesit në Internet i marrë nga operatorët e rrjeteve të tjera.
  - f. përfitimet e përdoruesve fundorë nga detyrimi i ofrimit të terminimit të thirrjeve hyrese nderkombetare, janë indirekte dhe janë të lidhura me përfitimin e një sasi me të madhe të thirrjeve hyrese (megjithatë përdoruesi fundor nuk paguan) por të varuara nga transmetimi i reduktimeve të tarifës së terminimit midis tranzituesve të ndryshëm deri tek operatorët origjinues të këtyre thirrjeve dhe reduktimi nga këta operatorë jashtë RSH i tarifave të thirrjeve drejt Shqipërisë, reduktime të cilat janë jashtë kontrollit të AKEP apo operatorit terminues.
5. Në lidhje me pretendimet për asimetrinë, shprehur në pikën 2 të ankimit, AKEP gjykon se qendrimi i mbajtur në analizë dhe reduktimi i asimetrisë midis Vodafone/AMC dhe EM është i arsyeshëm madje në kushtet e komercializmit të tarifës së thirrjeve hyrese nderkombetare, gjykon se asimetria është e arsyeshme të rritet.. Eliminimi i asimetrisë dhe afati kohor i saj do të përcaktohen me një vendim të vecantë të AKEP, i cili do të merret brenda vitit 2010.
  6. Në lidhje me pretendimet për FNT për akses/origjinim të thirrjeve, të shprehur në pikën 3 të ankimit, AKEP gjykon se detyrimet për origjinimin e thirrjeve në rrjetin Vodafone Albania i shërbejnë rritjes së konkurrencës në tregun me pakicë celular në Shqipëri dhe plotësimin të objektivave të ligjit 9918, dhe se AKEP ka bërë arsyetimin e vendimit në dokumentin e analizës së tregut.
  7. Në lidhje me pretendimin e Vodafone Albania se në dokumentin për keshillim publik në Korrik 2009, AKEP nuk është shprehur në lidhje me tarifën e aksesit për 10.5 leke/min, rezultoi se nuk qendron, sepse në këtë dokument të konsultuar me VKD nr.748 datë 17.07.2009, në faqe 80 të tij është thënë se:  
*“Ofrimi i shërbimeve të akses/origjinimit nga AMC dhe Vodafone Albania , do të jetë risi në tregun Shqiptar, dhe bërja efektive e masave të mesipërme, mund të kerkojë me shumë kohë se ai i masave rregulluese për terminimin e thirrjeve. Megjithatë në lidhje me tarifimin e shërbimit të origjinimit të thirrjeve dhe nivelin e saj, AKEP*

*gjykon te ndjeke te njejten strategji si dhe per rregullimin e tarifes se terminimit ne rrjetet e AMC dhe Vodafone, duke aplikuar tarife te njejte per terminimin dhe origjinimin e thirrjeve”.*

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E :**

Bazuar ne piken 1 te nenit 114 dhe piken 1 te nenit 115, te ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues te K.Pr.A, si dhe piken 17 te nenit 21 te Rregullores se Brendshme,

## **V E N D O S :**

1. Te pranoje pjeserisht ankimin administrativ te Vodafone Albania.
2. Ne VKD nr.1211 date 31.03.2010 “Per percaktimin e sipermarresit Vodafone Albania sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”:

a. pika 4.3 te ndryshoje si me poshte vijon:

*4.3.1. Vodafone Albania sh.a per terminimin e thirrjeve ne rrjetin celular Vodafone Albania, duhet:*

- 1. t’u ofrojë palëve të treta akses dhe interkoneksion në rrjet dhe elementet e tij;*
- 2. te ofrojë terminim te thirrjeve hyrese derkombetare ne nivel shumice, per t’u rishitur nga operatoret e autorizuar nga AKEP;*
- 3. të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;*
- 4. të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;*
- 5. të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit.*

*Detyrimi per akses ne pikat e mesiperme i referohet vetem aksesit per mundesimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Vodafone Albania, dhe jane te zbatueshme sipas mundesive/afesive teknike dhe ekonomike te Vodafone Albania, si edhe me tarifa te cilat mbajne parasysh investimet e kryera dhe nje norme te arsyeshme fitimi.*

b. Pika 4.4.1 te ndryshohet si me poshte

*Tarifa e terminimit te thirrjeve dhe sherbimeve te interkoneksionit te lidhura me terminimin e thirrjeve ne rrjetin Vodafone Albania jane:*

- i. Objekt kontrolli nga AKEP per terminimin e thirrjeve te origjinuara nga abonentet e rrjeteve publike telefonike ne RSH, sipas percaktimeve ne pikat 2 dhe 3 me poshte;*

ii. Objekt negociatash komerciale per terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare.

c. te shtohet pika 10.3 si me poshte vijon :

*“Detyrimet aktuale te Vodafone Albania per tarifen e terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare shfuqizohen. Heqja e ketyre detyrimeve behet efektive me 1.11.2010”.*

3. Seksionet e Analizes se tregut celular ne lidhje me terminin e thirrjeve hyrese nderkombetare, ndryshohen per sa me siper.
4. Te mos pranoje kerkesen nr. 2 te ankimit adminsitrativ, lidhur me heqjen e asimetrise se tarifave te terminimit te aplikuara ndaj operatoreve te tjere te telefonise se levizshme, dhe kerkesen nr.3 te ankimit administrativ, lidhur me mospercaktimin e Vodafone Albania me FNT ne tregun me shumice te akses origjinimit dhe heqjen e detyrimeve ex-ante per kete treg.
5. Te gjitha percaktimet e tjera te Vendimit nr.1211 date 31.03.2010 “Per percaktimin e sipermarresit Vodafone Albania sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, ngelen te pandryshuara dhe ne fuqi.
6. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit te AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

**ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:**

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURCE**